

**AKT- THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ELITE CAR” SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“ELITE CAR” Sh.p.k.**

- 1- Renaldo Ibrua** , atesia **Shpetim**, shtetas Shqiptar, lindur me 29/04/1990 ne Elbasan, identifikohet nepermjet pasaportes me nr. Personal J00429061J dhe nr.leternjoftimi 036935666.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **“ELITE CAR” Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1  
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte **“ELITE CAR” Sh.p.k.**,

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3  
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Toke are, Vishaj, Tirane Nr.15/8, Vol. 4, Fq.104, Zone Kadastrale 3784.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik. Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

**NENI 4  
KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE**

AKT THEMELIMI “ ELITE CAR” SHPK



Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

#### **NENI 5**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Shoqëria “ELITE CAR” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të dhenies me qera te makinave (makina me qera).

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve te ndryshme. Pjesmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojne përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

#### **NENI 6**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind Mije), i ndare në 1 pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

**1- Renaldo Ibrua**

**100,00 %**

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

#### **NENI 7**

#### **AKTET E SHOQERISE**

Shoqëria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

#### **NENI 8**

#### **ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “ELITE CAR” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e

2

**AKT THEMELIMI “ ELITE CAR” SHPK**



ortakëve mund të krijoje edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator të shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emeruar Renaldo Ibrua.

**NENI 9**  
**DISPOZITATE FUNDIT**

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

**Tirane, 11/04/2023**

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE**  
**“ELITE CAR” SH.P.K.**

Renaldo Ibrua

